

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7833  
E premte, 12 korrik 2024  
Çmimi 0.50 €

**PDK-ja: Qeveria ia humbi Kosovës 21 milionë euro, të barabarta me 42 mijë paga mesatare në Kosovë**

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OSMANI: KËRKOJMË GARANCI NDËRKOMBËTARE PËR ASOCIACIONIN.

FAQE 3



Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se vendi i saj kërkon garanci nga partnerët ndërkombëtarë për zbatimin

e detyrimeve që dalin nga marrëveshja e Ohrit. Osmani iu referua kryesisht çështjes së Asociacionit, pikës më të nxehtë në mosmarrëveshjet në mes të Prishtinës dhe

Beogradit. Presidentja Osmani ka thënë se i takon Kosovës të ndërmarrë hapa për Asociacionin dhe i takon Serbisë të ndërmarrë hapa drejt njohjes de fakto

### AKTUALE




**NË SREBRENICË SHËNOHET 29-VJETORI I GJENOCIDIT** F. 2

**KONJUFCA: SERBIA KA PRETENDIME TERRITORIALE NDAJ KOSOVËS** F. 3

Reagim i KMDLNj-së

**ARRATISJA, LARGIMI DHE MOSKTHIMI NË BURG, KUPTIM DHE DALLIM PËRMBAJTJESOR** F. 3

### EKONOMI



**GËRXHALIU: PAGESA E DËNIMIT NDAJ 'CONTOURGLOBAL', DËSHMI E FITORES SË MAFISË BALLKANIKE PËR ENERGJI ELEKTRIKE E LIDHUR ME POLITIKANË VENDORË** F. 8

**RIZVANOLLI: GJATË MUAJIT TETOR LANSOJMË PROJEKTET E REJA KONKURRUESE PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE TË ENERGJISË SË ERËS** F. 8

### SPORT



**KOSOVA E GATSHME PËR KAMPIONATIN E GRUPMOSHËS U20**

F. 10

**KUVENDI MIRATON PROJEKTLIGJIN E KONTESTUESHËM PËR MEDIET, AGK-JA: GODITJE NDAJ LIRISË SË MEDIËS** F. 7



**KUVENDI I KOSOVËS MIRATON STATUTIN E RI TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS, HEQ EMRIN HASAN PRISHTINA** F. 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Në Srebrenicë shënohet 29-vjetori i gjenocidit

**SREBRENICË, 11 KORRIK** - Në Srebrenicë më 11 korrik është shënuar 29-vjetori i gjenocidit, i kryer nga forcat serbe në Bosnjë-Hercegovinë.

Në Srebrenicë dhe zonat përreth, forcat serbe të Bosnjës vranë më shumë se 8 300 boshnjakë në korrik të vitit 1995.

Në Qendrën Përkujtimore Potoçari këtë vit varrosen mbetjet mortore të 14 viktimave të gjenocidit. Viktima më e re që do të varrosët është 17 vjeç, ndërkaq më e vjetra 68.

Për herë të parë këtë vit, 11 korriku shënohet si Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, pasi kjo organizatë miratoi një rezolutë për Srebrenicën më 23 maj.

Përfaqësuesi i lartë ndërkombëtar

në Bosnjë, Christian Schmidt, gjatë ceremonisë përkujtimore në Potoçari, tha se është e rëndësishme që shoqëria të kundërshtojë çdo përpjekje për ta minimizuar shkallën e gjenocidit në Srebrenicë. "Madhërimi i kriminelëve të luftës është fyerje, në mos kërcënim për viktimat, po ashtu është edhe shkelje e Kodit Penal të Bosnjë-Hercegovinës", tha ai.

Ndërkaq shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, tha se korriku i vitit 1995 ishte një prej kapitujve më të errët të historisë moderne evropiane.

"Srebrenica vazhdon të jetë një plagë e thellë në historinë e Evropës. Dështimi për të parandaluar këtë gjenocid është një barrë që ne vazhdojmë ta bartim", shkroi ai në një kolumne.



Borrelli tha, po ashtu, se në Bosnjë dhe në mbarë rajonin "ka ende një tendencë shqetësuese të mohimit. Çdo mohim i gjenocidit është shuplakë në fytyrën e drejtësisë dhe pengesë për pajtim".

Më herët gjatë ditës, Kuvendi i

Kosovës, në një seancë të jashtëzakonshme të thirrur për 29-vjetorin e gjenocidit në Srebrenicë, miratoi një deklaratë që përkujton dhe nderon viktimat e gjenocidit. Krimi në Srebrenicë më 2007 nga Gjykata Ndërkombëtare e

Drejtësisë në Hagë u njoh si gjenocid i kryer nga Ushtria e Republikës Sërpska. Srebrenica në korrik të vitit 1995 ishte zonë e mbrojtur e OKB-së.

Gjykata e njëjtë gjeti Serbinë fajtores për mosparandalimin e gjenocidit. Gjykata po ashtu tha se Serbia ka shkelur obligimin për të ndëshkuar kryesit e gjenocidit.

Para këtij vendimi disa gjykata kanë dënuar më shumë se 50 persona me mbi 700 vjet burgim për gjenocid dhe krime lufte në Srebrenicë.

Në mesin e tyre janë edhe ish-presidenti i Republikës Sërpska, Radovan Karaxhiq, dhe komandanti i përgjithshëm i ushtrisë së atëherëshme serbe, Ratko Mlladiq. Të dy janë dënuar me burgim të përjetshëm.

## Tajvani thotë se Kina është kërcënim për stabilitetin e rajonit



**TAIPEI CITY, 11 KORRIK** - Tajvani tha se po shikon nga afër ushtrinë kineze, e cila tha se paraqet kërcënim në rritje për rajonin, pasi Pekini dërgoi dhjetëra avionë pranë ishullit vetëqeverisës, në kuadër të stërvitjeve ushtarake të Kinës me Shandongun.

Stërvitjet ushtarake të Kinës përkohë me samitin e NATO-s në Uashington, ku në deklaratën e aleancës u tha se Kina është bërë një mundësuese e përpjekjeve të luftës së Rusisë në Ukrainë. NATO tha, po ashtu, se Pekini vazhdon të paraqesë sfidë sistematike për Evropën dhe sigurinë e saj.

Në informacionet ditore për

aktivitetet ushtarake të Kinës, Ministria e Mbrojtjes e Tajvanit tha të enjten se në 24 orët e fundit janë detektuar 66 avionë kinezë përreth ishullit.

Nga këta avionë, 33 kaluan mbi jetën jugore dhe juglindore të Tajvanit, tha Ministria e Mbrojtjes, ndërkaq tha se, po ashtu, ka detektuar 36 avionë që kaluan në perëndim të Paqësorit për të kryer stërvitje me Shandongun.

Duke folur me zyrtarët ushtarakë në Taipei, presidenti tajvanez, Lai Ching-te, tha se ai do të vazhdojë ta forcojë mbrojtjen e ishullit. "Kërcënimi nga komunistët kinezë për stabilitetin e rajonit

vazhdon të rritet dhe zona e tyre gri në Ngushticën e Tajvanit dhe zonat përreth po rritet dita-ditës", tha ai.

Tajvani ka thënë se Kina po përdor taktika "të zonës gri" që parandalojnë një luftë dhe për të testuar e për t'u bërë presion forcave tajvaneze.

Tajvani, të cilin Kina e sheh si pjesë të territorit të saj, është ankuar për aktivitetin e ushtrisë kineze në katër vjetët e fundit, teksa Pekini po synon të bëjë presion ndaj qeverisë demokratike të ishullit, e cila kundërshton pretendimet e Kinës ndaj ishullit.

## Macroni u bën thirrje partive me "vlera republikane" ta formojnë qeverinë e re

**PARIS, 11 KORRIK** - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, u bëri thirrje të mërkurën partive politike me "vlera republikane" t'i bashkohen forcat për ta formuar një shumicë të qëndrueshme në Asambledë Kombëtare të vendit, pasi zgjedhjet parlamentare të dielën nuk dhanë fitues të qartë.

Zgjedhjet, të cilat Macroni i thirri pasi humbi kundër të së djathtës ekstreme Tubimi Kombëtar në zgjedhjet evropiane, e kanë futur Francën në një rrugë qorre, me tri blloqe të kundërta politike dhe pa një shumicë që do ta formonte qeverinë e re.

Në një letër të publikuar në gazetën e vendit, Macroni u bëri thirrje

partive me "vlera republikane" ta formojnë një koalicion qeverisës dhe tha se shpreson se mund ta zgjedhë një kryeministër nga një grupim i tillë. "Të shpresojmë në aftësitë e liderëve tanë politikë për të treguar ndjesi, harmoni dhe qetësi në interesin e tyre dhe të vendit. Në frymën e këtyre parimeve, unë do të vendos për emërimin e një kryeministri", shkroi Macroni.

Fronti i Ri Kombëtar një koalicion i të gjelbërve, socialdemokratëve, komunistëve dhe partisë majtiste të Jean-Luc Melenchonit, Franca e Panënshtuar - fitoi befas më së shumti ulëse në zgjedhjet e së dielës, por jo shumicën e



nevojshme.

Koalicioni i qendrës i Macronit, "Bashkë", doli i dyti, ndërsa Tubimi Kombëtar i treti, pavarësisht se shpresonte se do ta fitonte shumicën pas një rritje të madhe që shënoi në rundin e parë të zgjedhjeve.

Do të ishte e zakonshme për Macronin t'i kërkojë grupit më të madh parlamentar, në këtë rast bllokut majtist, ta formojë Qeverinë e re, por asgjë në Kushtetutë nuk e detyron atë ta bëjë këtë.

Macroni nuk kërkoi qartazi që Tubimi Kombëtar dhe Franca e Panënshtuar të përjashtohet nga koalicioni për formimin e Qeverisë, por përmendja e "vlerave

republikane" nga ai kuptohet si përjashtim i partive të së majtës ekstreme apo të së djathtës ekstreme.

Disa ligjvënës nga Partia Franca e Panënshtuar reagon ndaj letrës së Macronit, duke thënë se ai duhet ta pranojë kandidatin e aleancës majtiste për kryeministër, sapo ajo ta përzgjedhë atë, dhe ta lejojë atë ta formojë Qeverinë e re. "Gjëja më e mirë që ai mund të bëjë për vendin në këtë kohë, është ta lejojë grupin që fitoi më së shumti ulëse, Fronti i Ri Popullor, të qeverisë. Çfarëdo dredhie tjetër do të ishte shumë problematike dhe e rrezikshme për demokracinë", tha njëri nga ta, Eric Coquerel, në televizionin LCI.

# Kuvendi i Kosovës miraton deklaratë për gjenocidin në Srebrenicë

PRISHTINË, 11 KORRIK - Kuvendi i Kosovës, në një seancë të jashtëzakonshme të thirrur për 29-vjetorin e gjenocidit në Srebrenicë, miratoi një deklaratë që përkujton dhe nderon viktimat e gjenocidit. Në Srebrenicë dhe zonat përreth, forcat serbe të Bosnjës vranë më shumë se 8 300 boshnjakë në korrik të vitit 1995.

Nënkryetari i Kuvendit, Bahrim Shabani, i cili i përket komunitetit boshnjak, lexoi deklaratën që tha se kundërshton mosndëshkimin e kryesve të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljeve të tjera të të drejtës humanitare ndërkombëtare.

Deklarata thotë se Kosova mbështet kërkimin e paqes së qëndrueshme, drejtësinë dhe pajtimin. Aty vlerësohet miratimi i një rezolute nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara që shpall 11 Korrikun - Ditë Ndërkombëtare për Përkujtimin e Gjenocidit.

Shabani tha se Kosova solidarizohet me të mbijetuarit e gjenocidit në Srebrenicë, duke theksuar se kujtimi i "Srebrenicës

të shërbejë si kujtesë e mprehtë e përgjegjësisë kolektive për të parandaluar tragjedi të tilla në të ardhmen".

Zëvendëskryeministria e Kosovës nga komuniteti boshnjak, Emilija Rexhepi, duke folur për gjenocidin në Srebrenicë, theksoi se "është detyra jonë që gjithmonë ta kundërshtojmë urrejtjen dhe diskriminimin, të flasim dhe ta ngremë zërin kundër një padrejtësie të tillë".

Një ditë më herët Qeveria e Kosovës mori vendim që ta shpallë 11 Korrikun - Ditë Përkujtimore të Gjenocidit në Srebrenicë. Ndërkaq, më 2021, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar një rezolutë për dënimin e gjenocidit në Srebrenicë të Bosnjë-Hercegovinës.

Në Qendrën Përkujtimore Potoçari në Srebrenicë, në 29-vjetorin e gjenocidit, do të varrosen mbetjet mortore të 14 viktimave të gjenocidit. Viktima më e re që do të varrosen ishte 17 vjeç, ndërkaq më e vjetra 68.

Më 2007 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë lëshoi një vendim që thotë se Ushtria e



Republikës Sërpska kreu gjenocid në Srebrenicë në korrik të vitit 1995. Atëbotë, Srebrenica ishte zonë e mbrojtur e OKB-së.

Gjykata e njëjtë gjeti Serbinë fajtoresh për mosparandalimin e gjenocidit. Gjykata, po ashtu, tha se Serbia ka

shkelur obligimin për t'i ndëshkuar kryesit e gjenocidit.

Para këtij vendimi disa gjykata kanë dënuar më shumë se 50 persona me mbi 700 vjet burgim për gjenocid dhe krime lufte në Srebrenicë.

Në mesin e tyre janë edhe ish-presidenti i Republikës Sërpska, Radovan Karaxhiq, dhe komandanti i përgjithshëm i ushtrisë së atëhershme serbe, Ratko Mlladiq. Të dy janë dënuar me burgim të përjetshëm.

## Konjufca: Serbia ka pretendime territoriale ndaj Kosovës



PRISHTINË, 11 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, u është kundërpërgjigjur kritikave se me deklaratat e tyre për luftë po frikësojnë qytetarët.

Konjufca në një deklaratë para gazetarëve të enjten ka thënë se Serbia ka pretendime territoriale ndaj Kosovës. "E di e gjithë shoqëria jonë, populli dhe bashkësia ndërkombëtare, se

Serbia ka pretendime territoriale ndaj Kosovës dhe prej këtyre pretendimeve ajo nuk ka hequr dorë kurrë. Po të njëjtën kohë edhe Kosova kurrë nuk ka qenë më e përgatitur për t'iu përgjigjur çfarëdo sfide të sigurisë, kështu që populli i Kosovës duhet me qenë i sigurt. Askush nuk i thotë këto deklarata për t'i frikësuar apo për të shkaktuar ndonjë panik. Populli i Kosovës është shumë i

qetë. Populli i Kosovës beson në shtet. Populli i Kosovës dhe shoqëria jonë besojnë në institucionet tona efektive për t'iu kundërvënë çfarëdo tendence të Serbisë për ta destabilizuar Kosovën. Kështu ka qenë dhe kështu do të jetë gjithmonë", u shpreh Konjufca.

Ai ka theksuar se ka grupe të cilat duan dhe kanë synim ta destabilizojnë Kosovën. "Se ka

grupe të cilat kanë synim destabilizimin e Kosovës, ne nuk mund të gënjejmë as mashtrujmë askënd. Ato ekzistojnë, janë të strehuara në Serbi. Mirëpo, brenda Kosovës situata kurrë nuk ka qenë më në kontroll. Grupet brenda Kosovës, të cilat mund ta destabilizonin Kosovën, kurrë nuk kanë qenë më të dobëta dhe janë në shpartallim e sipër. Prej Serbisë ku ushtrojnë ata, ku i

marrin armët, ku gjejnë strehim, ato janë të konfirmuara edhe prej institucioneve tona të sigurisë. E institucionet tona të sigurisë na i bartin neve kërëve të shtetit dhe na tregojnë se ato grupe ekzistojnë. Ku ekzistojnë, ku trajnohen dhe cili është qëllimi i tyre", u shpreh tutje Konjufca. Kryetari i Kuvendit më tej tha se bashkësia ndërkombëtare duhet ta ndëshkojë Serbinë.

## Kurti: Lidhjet e shtetit tonë me Zvicrën janë të fuqishme

Prishtinë, 11 korrik - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim kryetarin e Këshillit Kombëtar të Zvicrës, Eric Nussbaumer, bashkë me delegacionin e udhëhequr nga ai, pjesë e së cilës ishin dhe dy

miq të Kosovës, bashkëkryetarët e grupit parlamentar të miqësisë Zvicër - Kosovë, Cedric Wermuth dhe Marc Jost.

Kurti ka theksuar se lidhjet e shtetit tonë me Zvicrën janë të fuqishme dhe karakterizohen

veçanërisht nga bashkëpunimi në aspektin ekonomiko-kulturor. "Mërgata atje është ura që jo vetëm na lidh me shoqërinë zvicerane, por edhe që ndihmon zhvillimin dhe progresin e vendit tonë. E

falënderova shtetin e Zvicrës për mbështetjen e vazhdueshme dhe gatishmërinë e vullnetin për lidhje edhe më të forta e të ngushta ndërmjet dy vendeve tona", ka theksuar Kurti pas takimit.





# Osmani: Kërkojmë garanci ndërkombëtare për Asociacionin

Në një intervistë për “Zërin e Amerikës” presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se vendi i saj kërkon garanci nga partnerët ndërkombëtarë për zbatimin e detyrimeve që dalin nga marrëveshja e Ohrit. Osmani iu referua kryesisht çështjes së Asociacionit, pikës më të nxehtë në mosmarrëveshjet në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Presidentja Osmani ka thënë se i takon Kosovës të ndërmarrë hapa për Asociacionin dhe i takon Serbisë të ndërmarrë hapa drejt njohjes de fakto

PRISHTINË, 11 KORRIK - Në një intervistë për “Zërin e Amerikës”, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, thotë se vendi i saj kërkon garanci nga partnerët ndërkombëtarë për zbatimin e detyrimeve që dalin nga marrëveshja e Ohrit. Osmani iu referua kryesisht çështjes së Asociacionit, pikës më të nxehtë në mosmarrëveshjet në mes të Prishtinës dhe Beogradit. Osmani foli për garanci për sigurinë e mbështetje ndërkombëtare për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, çka do të sillte, siç tha, më shumë paqe e siguri në rajon. Ajo shtoi se Kosova nuk po kërkon t’u largohet detyrimeve të saj, por të ketë “zbatim paralel të marrëveshjes së arritur në Bruksel, e njohur si Marrëveshja Bazë dhe Aneksi i Ohrit, ku ka detyrime për Kosovën, por dhe detyrime të qarta për Serbinë, të cilat në

tërësinë e tyre nënkuptojnë njohje de fakto të Republikës së Kosovës”. Presidentja Osmani i bëri komentet ndërsa ndodhet në Uashington me ftesë të sekretarit të Shtetit, Anthony Blinken, për të marrë pjesë në takime që mbahen në kuadër të takimit të nivelit të lartë të NATO-s. “Dialogu Kosovë - Serbi nuk është e tërë marrëdhënia Kosovë - Amerikë. Mos ta reduktojmë raportin special ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara vetëm me atë që ndodh në dialogun me Serbinë. Natyrisht është aspekt i rëndësishëm për sigurinë në rajon dhe për të ardhmen tonë euroatlantike që të ketë sukses në procesin e dialogut. Kjo është arsyeja e këmbënguljes së vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve tanë të tjerë sepse sa më shumë që të ketë suksese në dialog aq më

shpejt do të bëjë Kosova hapa vendimtarë drejt BE-së dhe NATO-s. Por duhet ta bëjmë një gjë të qartë. Në çdo kontratë, në çdo marrëveshje janë dy palë dhe është parim bazik i të drejtës ndërkombëtare që në qoftë se një palë tërhiqet nga marrëveshja, atëherë pala tjetër nuk ka asnjë detyrim që të zbatojë pjesë të asaj marrëveshje. Ajo çfarë po insistojmë ne si Kosovë është jo që ne të ikim nga obligimet tona, por që të ketë zbatim paralel të marrëveshjes së arritur në Bruksel, e njohur si Marrëveshja Bazë dhe Aneksi i Ohrit, ku ka obligime për Kosovën, disa prej të cilave kanë qenë koncesione të vështira, por ka edhe obligime të qarta për Serbinë, të cilat, në qoftë se merren në tërësinë e saj, konstituojnë njohje de fakto të Republikës së Kosovës siç është potencuar qartë edhe nga liderët evropianë në deklaratën e tyre të 26 tetorit”, ka thënë Osmani. Ajo ka shtuar se nuk mundet Serbia të deklarohet hapur dhe të dërgojë letër nga ana e kryeministres që po tërhiqen në tërësi dhe nuk do ta zbatojnë marrëveshjen dhe ne të ofrohem si vullnetarë që gjithçka të zbatojmë pa marrë garanci në anën tjetër. “Ajo çfarë e kam thënë edhe në intervistën e fundit, në fakt për ‘Zërin e Amerikës’ para pak muajsh kur isha në seancën e Këshillit të Sigurimit, është kjo: në qoftë se

të gjithë jemi të bindur, edhe ne edhe partnerët tanë, që Serbia nuk do ta zbatojë pjesën e saj të marrëveshjes, atëherë ne duhet t’i rikthehemi strategjisë së viteve 2007-2008, në kohën kur bëheshin negociatat për statusin e Kosovës. Marrëveshja jonë, dakordimi ynë, ka qenë me partnerët, jo me Serbinë, sepse Serbia nuk e donte Ahtisaarin dhe neve na duhet një dakordim i tillë. Nëse Kosova do t’i zbatojë të gjitha këto detyrime që i ka marrë, na duhen garanci për sigurinë, mbështetje ndërkombëtare, anëtarësim në organizata ndërkombëtare, jo si transakcion, por si projekt i cili përfundimisht e mbyllë këtë temë dhe sjell më shumë paqe e siguri në rajon”, ka theksuar Osmani. Presidentja ka thënë se i takon Kosovës që të ndërmarrë hapa për Asociacionin dhe i takon Serbisë të ndërmarrë hapa drejt njohjes de fakto. “Të dyja janë në marrëveshjen e njëjtë. Ne nuk mund t’i injorojmë nenet 1 deri 6 dhe të kërcejmë vetëm te neni 7 dhe ta kërkojmë vetëm zbatimin e një neni. Kosova nuk po thotë që nuk do të formohet Asociacioni”, ka pohuar Osmani. Osmani ka thënë se në raport me qytetarët tanë ne nuk do të duhej ta krijojmë përshtypjen që Asociacioni ndihmon qytetarët serbë në Kosovë. “Në fakt, sistemi më i avancuar i të

drejtave të pakicave ekziston në Republikën e Kosovës tani, me Kushtetutën aktuale, me ligjet e pakos së Ahtisaarit dhe me ligjet e tjera të cilat ne i kemi miratuar si rezultat i marrëveshjeve të dialogut. Me Asociacionin, ju siguroj një gjë, vetëm sa pakësohen të drejtat e qytetarëve dhe fuqizohet një lloj pushteti mbi ta, pra liderët e Asociacionit, të cilët Vuçiqi për momentin e ka qëllimin t’i kontrollojë dhe në njëfarë mënyre ta bëjë Kosovën shtet jofunksional. Pra Asociacioni nuk u jep më shumë të drejta qytetarëve serbë, por përkundrazi merr më shumë të drejta nga poshtë dhe i dërgon ato lart, që është në kundërshtim me parimet bazë të Këshillit të Evropës, sipas të cilit, për t’i fuqizuar komunitetet pakicë, duhet të ketë më shumë sovranitet nga lart poshtë dhe jo e kundërta. Asociacioni, në fakt, bën të kundërtën. Edhe vetë juristët eminentë të Këshillit të Evropës kanë deklaruar që ajo nuk është në përputhje me parimet e Këshillit të Evropës. Megjithatë, ne e kemi dhënë premtimin dhe Kosova është shtet serioz. Kur ndërmerr një detyrim ndërkombëtar duhet ta zbatojë atë, por zbatimi i Asociacionit është në kuadër të një procesi dhe ai proces është Marrëveshja Bazë”, ka deklaruar Osmani.

# PDK-ja: Qeveria ia humbi Kosovës 21 milionë euro, të barabarta me 42 mijë paga mesatare në Kosovë



PRISHTINË, 11 KORRIK - Partia Demokratike e Kosovës ka reaguar pas vendimit të qeverisë Kurti për t'i dhënë 21 milionë euro kompanisë "Contour Global" si epilog i procesit të arbitrazhit pas dështimit të ndërtimit të termocentralit.

Anëtari i kryesisë së PDK-së, Bernard Nikaj, në një konferencë për medie, tha se përtej humbjes financiare,

menaxhimi i munguar dhe i dështuar i këtij projekti dëshmon se qeveria ka dështuar të ndërtojë një vizion të qartë dhe të qëndrueshëm për adresimin e nevojave të qytetarëve të Kosovës për furnizim me energji. "Dje Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi të paguajë 21 milionë euro si pasojë e humbjes së procesit të Arbitrazhit ndaj

kompanisë 'Contour Global'. 21 milionë euro janë të barabarta me 42 mijë paga mesatare në Kosovë", theksoi ai.

Nikaj rikujtoi se qeveria nuk ka arritur t'i përfundojë projektet e nisura e as nuk ka nisur ndonjë projekt të ri në këtë fushë. "Përveç projektit të Termocentralit të Ri, qeveria e udhëhequr nga LV-ja ka anuluar edhe projektin e

gazit natyral, projekt i cili ishte nisur dhe përkrahur nga MCC, por edhe nga donatorë të tjerë siç janë EBRD dhe Komisioni Evropian. Rezultat i të gjitha këtyre dështimeve janë çmimet e larta të energjisë sot, të cilat qytetarët tanë i përjetojnë çdo ditë e çdo muaj në faturat e tyre, por edhe një pasiguri e skajshme e furnizimit posaçërisht në muajt e dimrit", shtoi ai.

Ndërsa anëtari tjetër i kryesisë, Blerand Stavileci, ka thënë se dështimi i këtij projekti është një dëm i madh që i është shkaktuar buxhetit dhe ekonomisë së vendit tonë. "Gjendja në të cilën jemi, mbi të gjitha rritja e tarifave dy herë brenda dy viteve, edhe pse asnjë megavat nuk iu shtua sistemit, na tregojnë që dështimin e qëllimshëm të këtij projekti nga kjo qeveri, përveç parave të paguara nga buxheti i taksapaguesve, do ta paguajmë edhe shumë vite më pas, sepse asnjë nga projektet aktuale nuk e zgjidh ngarkesën e furnizimit bazë dhe siguria e furnizimit do të jetë sfida më e madhe dhe problem i vazhdueshëm i sistemit dhe sektorit, e kjo do të thotë që do të vazhdojmë të jemi thellësisht e tmerrësisht të varur nga importi", shtoi ai. Stavileci tha se qytetarët e Kosovës kanë nevojë për një vizion të qartë, i cili siguron qëndrueshmëri energjetike me çmime të përballueshme. "Të gjitha vonesat, mospuna dhe paaftësia e kësaj qeverie do të faturohen në kurrizin e qytetarëve, në dëm të së ardhmes së tyre. Ekonomia e vendit tonë dhe qytetarët e këtij vendi kanë nevojë për energji dhe ekonomi të qëndrueshme dhe çmime të përballueshme në mënyrë që të kenë standard të mirë jetese. Fatkeqësisht, kjo nuk mund të pritët nga qeveria e udhëhequr nga LV", theksoi Stavileci.

## Rasti i 'ContourGlobal', Haradinaj: Kurti dhe klika e tij janë kriminelë

PRISHTINË, 11 KORRIK - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar sërish të enjten pasi Qeveria e Kosovës ka miratuar pagesën prej 21 milionë eurosh si dëmshpërblim ndaj kompanisë "ContourGlobal". Ai ka shtuar se kryeministri Albin Kurti dhe klika e tij që kanë ndëshkuar kompaninë amerikane "Contour Global" janë kriminelë. "Kriminelët kthehen në vendin e krimit shpesh sepse nuk ndëshkohen. Kurti dhe klika e tij që e kanë ndëshkuar 'ContourGlobalin' janë kriminelë", tha Haradinaj.

Ai tha se investimi i "ContourGlobal" prej 1.3 miliardësh ka qenë investimi më i madh i kontraktuar në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë. "Investimi me

qindra vende të reja të punës dhe shumë projekte për kompani partnere vendore dhe të Kosovës. Termocentrali i ri prej 500 megavatesh do t'i jepte Kosovës stabilitet dhe pavarësi të përhershëm energjetike me çmime shumë të ulëta se të gjitha çmimet e tregut pas vitit 2021. Ndërtimi i Kosovës C do ta bënte Kosovën të pandikueshme nga, p. sh., lufta në Ukrainë apo çfarëdo krize tjetër globale. Nga rritja e çmimit të energjisë në tregjet globale Kosova do të fitonte miliona, kurse vetëm në tri vitet e fundit Kosova ka shpenzuar mbi 500 milionë euro, mbase më shumë për import të energjisë elektrike. Krejt me para dhe fatura të fryra të popullit", tha Haradinaj.



Reagim i KMDLNj-së

## Arratisja, largimi dhe moskthimi në burg, kuptim dhe dallim përmbajtjesor

Ditë më parë lajmi kryesor i mediave ishte "arratisja" nga Burgu i Smrekonicës i të dënuarit Faton Hajrizi e që ishte arratisja e tij e 9-të. Burgu në Smrekonicë është burg i tipit të hapur ku nevoja për mbikëqyrje është thuajse minimale apo e panevojshme për faktin se aty të dënuarit kanë beneficione të mëdha dhe janë në prag të lirimit andaj nuk kanë asnjë arsye të largohen sepse shumë pak fitojnë me largim ndërsa i humbin të gjitha të drejtat dhe përfitimet që i kanë fituar me sjellje të mire. Me pak investime, Burgu në Smrekonicë ka mundur të bëhet model për vendet e Ballkanit dhe më gjerë po të ruheshin kriteret e mëparshme. Tash, sidomos gjatë katër viteve të fundit, këto kritere kanë degraduar shkaku i ndikimit politik apo korrupsionit administrativ dhe aty janë transferuar të dënuar që me asgjë nuk i plotësojnë kushtet të jenë në Smrekonicë. Oficerët korrektues nuk mund të kundërshtojnë këto transferime prandaj edhe e pësojnë sikur me rastin e largimit të Faton Hajrizit me ç'rast u suspenduan dy oficerë, sipas KMDLNj krejtësisht padrejtësisht.



Vetëm në rast se dëshmohej se këta oficerë kanë ndihmuar në largimin e Faton Hajrizit, suspendimi konsiderohet i arsyeshëm. Faton Hajrizit i është dhënë mundësia nga SHKK të shfrytëzojë beneficionet, të përfitojë edhe nga lirimi i parakohshëm ndërsa, me largimin, jo arratisjen nga Burgu i

Smrekonicës, me fajin ekskluzivisht të tij, me të drejtë i humbë të gjitha dhe kurdo që do të kapet nga organet e sigurisë do të dërgohet në institucion të mbajtjes së sigurisë së lartë, nën mbikëqyrje të shtuar dhe gjasat për rikthim të beneficioneve janë kurrfarë hiç. Publiku duhet ta ketë të qartë se Faton Hajrizi ishte

dënuar 6 vite për vrasje të një ushtari rus të KFOR-it, si 15-vjeçar ndërsa 16-17 vite të tjera të burgut thuajse 23 vjeçar i janë dhënë nga gjykatat për shkak të veprave të ndryshme penale të kryera gjatë kohës sa ishte në arrati. KMDLNj kërkon që oficerët e suspenduar (nëse nuk kanë

ndihmuar të dënuarin Faton Hajrizi të largohet nga Burgu i Smrekonicës) të kthehen në punë sikur që të bëhet një auditim i pavarur për të vërtetuar rastet kur të dënuarit janë transferuar në Burgun e Smrekonicës në kundërshtim me ligjin dhe kriteret e përcaktuara. Edhe për rastet Enver Sekiraqa dhe Marko Rosiq, gjykatat nuk kanë përgjegjësi për moszbatim të vendimeve gjyqësore shkaku se të njëjtin janë larguar para se të bëhet ekzekutimi i masës së shqiptuar. Arratisja, largimi apo moskthimi në burg pas shfrytëzimit të fundjavës apo ndonjë përfitimi tjetër më së shumti i dëmton të dënuarit që e marrin këtë vendim dhe veprim. KMDLNj fton të punësuarit në SHKK të mos zbatojnë vendimet që janë në kundërshtim me ligjin e që kushtëzohen nga politika dhe politikanët sepse faturat do t'i paguajnë ata dhe jo politikanët dhe politika. Sikur deri më sot, SHKK dhe Paneli për Lirim me Kusht duhet të jenë të pavarura nga ndikimi i politikës dhe grupeve të interesit në ushtrimin e përgjegjësi të tyre që ua garantojnë ligjet në fuqi.

## Më 16 korrik Specialja shpall aktgjykimin kundër Pjetër Shalës

**PRISHTINË, 11 KORRIK** - Më 16 korrik, në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, do të shpallet aktgjykimin kundër ish-pjesëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Pjetër Shala, që akuzohet për krime lufte.

Shala ishte arrestuar në mars të vitit 2021 në Belgjikë dhe ishte transferuar në objektin e paraburgimit të Dhomat e Specializuara në prill të atij viti. Gjykimi ndaj tij nisi më 21 shkurt të vitit 2023 dhe në këtë proces gjyqësor morën pjesë tetë viktima. Ai është deklaruar i pafajshëm për katër pikat e aktakuzës: ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme.

Sipas aktakuzës, pretendohet se në mes 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, Pjetër Shala dhe disa ushtarë, policë dhe roje të UÇK-së, "morën pjesë në ndalimin arbitrar, trajtimin mizor, torturën dhe në një rast në vrasjen e paligjshme të një të ndaluarit në fabrikën e metalit në Kukës në veri të Shqipërisë".

Në aktakuzë thuhet se viktima të krimeve, të cilat pretendohet se i ka kryer Shala, ishin persona që



dyshohej se bashkëpunonin me Serbinë ose nuk e përkrahnin UÇK-në. Aty pretendohet se të

ndaluarit në një fabrikë metali në Kukës u keqtrajtuar rregullisht, goftë fizikisht apo psikologjikisht.

Sipas aktakuzës, Shala thuhet se "kontribuoi në mënyrë të konsiderueshme në krimet e pre-

tenduar, përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë dhe mosmarrjes së masave adekuate për të mundësuar trajtimin njerëzor të të ndaluarve në fabrikën e metalit në Kukës, dhe duke ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve për të cilat u ngritën akuzat".

Deri më tani, Dhomat e Specializuara, që njihen edhe si Gjykata Speciale, kanë shqiptuar dënim për pengim të drejtësisë ndaj ish-kreerëve të Organizatës së Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati, të cilët vitin e kaluar u liruan me kusht.

Ndërkaq, aktualisht në Dhomat e Specializuara është duke u zhvilluar një rast gjyqësor, ai ndaj ish-kreerëve të UÇK-së - Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi që akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

## Policia e Kosovës hap konkurs pune për minoritetet në veri

**PRISHTINË, 11 KORRIK** - Policia e Kosovës ka hapur konkurs pune për zyrtarë policorë nga të gjithë minoritetet që jetojnë në vend,

në Drejtorinë Rajonale të Mitrovicës së Veriut. Në rrjetin social të faqes zyrtare të Policisë së Kosovës në "Facebook" bëhet

me dije se konkursi është shpallur për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të

gjitha minoritetet (serb, boshnjak, turk, goran, rom, ashkali, egjiptian, kroat, malazez, maqedonas).



# Kuvendi i Kosovës miraton statutin e ri të Universitetit të Prishtinës, hiqet emri i Hasan Prishtinës

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 KORRIK - Kuvendi i Kosovës ka miratuar të enjten statutin e ri të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", duke e hequr emrin e heroit kombëtar Hasan Prishtina. "Me 61 deputetë që kanë marrë pjesë në votim, konstatohet se kalon Statuti i Universitetit të Prishtinës", ka thënë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca.

Të pranishëm në sallën gjatë votimit të këtij statuti ishin vetëm deputetët e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje.

Në anën tjetër, statuti i ri i Universitetit të Prishtinës, i votuar nga Senati i UP-së në fund të muajit korrik, u votua në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, më 12.10.2023.

Statuti i ri i UP-së u miratua më 14.05.2024 në Komisionin për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport.

## Fondacioni "Hasan Prishtina": Dora shqiptare vret për herë të dytë Hasan Prishtinën

Fondacioni "Hasan Prishtina" ka reaguar pasi Kuvendi i Kosovës sot votoi për statutin e ri të Universitetit të Prishtinës, duke e hequr emrin e patriotit dhe kolosit

Hasan Prishtina.

Ky fondacion ka theksuar se me këtë akt dora shqiptare vret për herë të dytë Hasan Prishtinën. "Data e sotme, 11.07.2024, do të mbetet në kujtesën tone si data e 'vrasjes' së dytë të heroit kombëtar Hasan Prishtina, për fatin e rëndë u vra prapë nga dora shqiptare, u vra pabesisht nga të zgjedhurit e popullit të tij. Deputetët që sot gjeten kuraje ta ngrisin dorën që të aprovojnë heqjen e emrit të Hasan Prishtinës nga Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina' do të mbahen mend për ligësinë dhe paturpësinë që treguan, jemi të vetëdijshëm se lloji i këtyre deputeteve nuk kane memorie historike që te vlerësojnë kontributin e papërsëritshëm të Hasan Prishtinës, për këtë arsye përmes Fondacionit 'Hasan Prishtina' ju kemi dërguar dy here shkresa me të cilat iu kemi bërë thirrje për mos votim dhe iu kemi dhënë argumente se pse ky emër nuk do duhej të hiqej nga Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina'. Siç duket për këta të mjerë, më i rëndësishëm është servilizmi ndaj bijës së grekut Dejona Mihajli, se sa vetë mbrojtja e vlerave kombëtare", është thënë në reagimin e Fondacionit "Hasan Prishtina".

Më tej në reagim theksohet se: "Deputetë pa kurriz, servilë, të poshtëruar madje nga ky nivel duken edhe të gërditshëm, si guxon që ky nivel të përfaqësoj popullin në institucionin me të lartë siç është Kuvendi i Republikës së Kosovës,



një tabor i deputetëve opozitar që le frontin dhe ikën dhe tabori tjetër që pa piken e turpit qon dore mbi Hasan Prishtinën. Është e rende, që eshtrat e Hasan Prishtinës nga varri po lëkunden, është bizare të mendohet e lere me të veprohet në këtë mënyrë, një kryeministër që sa ishte në opozite kishte gojën plot me emrin e Hasna Prishtinës, parapëlqente që ta krahasonin me të, sot ngre dore mbi të, një tufë deputetesh që ngjasojnë ne dele, që ndjekin verbërisht një kryeministër të dyshimtë, të bëjnë të mendosh se a mos valle po shkon huq gjaku i derdhur për këtë shtet!"

Fondacioni "Hasan Prishtina" ka theksuar se kjo çështje të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese si instancë e fundit. "Po e mbyllim këtë reagim me thënien e Kolosit Hasan

Prishtina, thënie e cila sot është aktuale më shumë se kurrë më parë: 'Mëmëdheu qan trima e burra, por jo për qyqarë e tradhtarë'".

## ORCA: Statuti i ri i Universitetit të Prishtinës, një hap para në cilësinë e arsimit

Për statutin e ri të UP-së ka reaguar organizata ORCA. "Me entuziazëm pranuam lajmin se është miratuar statuti i ri i Universitetit të Prishtinës, i cili shënon një hap domethënës para në rritjen e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë. Statuti i ri, ndonëse nuk përmban gjithçka që do të donte ORCA në kuptimin e kriterëve për zgjedhje dhe avancim

akademik, ai për dallim nga statuti i vjetër është fleksibil në avancimin e atyre kriterëve sipas trendeve globale në të ardhmen kur Universiteti ta shohë të arsyeshme", thuhet në reagim.

ORCA falënderoi deputetët që morën pjesë në votim dhe ata që votuan për statutin, me theks të veçantë deputetët minoritarë të Grupit Multietnik që treguan konstruktivitet dhe e bënë të mundur administrativisht miratimin. "ORCA çmon përkushtimin e ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci, në këtë proces, Këshillin Drejtues të UP-së të drejtuar nga Altin Sahiti, anëtarëve të komisionit draftues të Statutit në Universitetin e Prishtinës dhe rektorin aktual Qerim Qerimi", thuhet në reagim.

# Kuvendi miraton projektligjin e kontestueshëm për mediet, AGK-ja: Goditje ndaj lirisë së medias

Prishtinë, 11 korrik - Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancën e 11 korrikut e kanë miratuar Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve (KPM), i cili parasheh licencimin e medieve online, monitorimin e tyre dhe gjoba deri në 40 mijë euro. Ky projektligj u miratua në lexim të dytë me 59 vota për, asnjë kundër dhe dy abstenime.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, gjatë prezantimit të këtij projektligji, tha se Komisioni Parlamentar për Integritet ka deklaruar se amendamentet e projektligjit janë pjesërisht në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian. "Nuk paskam parë ndonjëherë kesi konstatimi që janë pjesërisht. Ka çështje të cilat në mënyrë universale nuk trajtohen nga legjislacioni i BE-së, prandaj shtetet i rregullojnë sipas mënyrave të veçanta të tyre", tha Konjufca. Sipas tij, nuk duhet votuar diçka që është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Në votim nuk morën pjesë deputetët e partive opozitare,



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të cilët u larguan nga seanca pasi që kërkesa e tyre për largimin e këtij projektligji nga rendi i ditës nuk u përkrah nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje.

Pas votimit reagoi juristja e medieve, Flutura Kusari, e cila tha se "sot është ditë e errët për demokracinë dhe lirinë e shprehjes dhe medias në Kosovë".

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e ka pranuar me shqetësim miratimin në

Kuvendin e Kosovës të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve. Miratimi i Ligjit për KPM-në, sipas AGK-së, është goditje ndaj lirisë së medias dhe tentim për disiplinim e kontroll të tyre. "Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit Kurti e ka miratuar ligjin me kuorumin minimal dhe pa prezencën e opozitës në sallë. Partia politike në pushtet nuk i ka marrë parasysh vërejtjet e shoqërisë civile e medieve, dhe ka shpërfillur raportin e ekspertës së Këshillit të Evropës, që ka konstatuar se pjesa më e madhe e Ligjit nuk i përmbushë standardet evropiane, duke

përfshirë ato të Këshillit të Evropës ku Kosova synon anëtarësimin. Një gjë e tillë, u theksua sot para votimit edhe nga Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca. Votimi i sotëm është prej goditjeve më të mëdha që Qeveria e Kosovës dhe Vetëvendosje ka bërë kundër lirisë së medias në Kosovë, në një përpjekje të nisur qysh prej fillimit të mandatit për disiplinimin dhe kontrollimin e tyre. Votimi i sotëm do të ketë një tjetër efekt negativ në renditjen e vendit në raportet ndërkombëtare të fushës", është thënë në reagimin e AGK-së.

AGK-ja bën thirrje për përdorimin e të gjitha mjeteve ligjore dhe kushtetuese për ta kundërshtuar hyrjen në fuqi të ligjit. Për të hyrë në fuqi, Projektligji për KPM-në, pas miratimit në Kuvend, duhet të nënshkruhet nga presidentja e vendit Vjosa Osmani. Për këtë projektligj ditë më parë ka reaguar edhe Zyra e BE-së në Kosovë, duke thënë se, pavarësisht se versioni aktual ka përfshirë disa rekomandime të Këshillit të Evropës, legjislacioni i duhur rishikime të mëtejme që të përmirësohet

qartësia ligjore dhe të përshtatet edhe më shumë me standardet e bllokut evropian dhe Këshillit të Evropës.

Ky projektligj është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 27 dhjetor të vitit të kaluar dhe është dërguar për miratim në Kuvendin e Kosovës, ku është miratuar në lexim të parë më 7 mars të këtij viti. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK) i patën bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të heqë dorë menjëherë prej ndryshimeve në projektligj, pasi diçka e tillë ishte konsideruar "sulm mbi mediet". Misioni i OSBE-së dhe i BE-së më herët kanë thënë se mbështesin qëllimin e projektligjit për ta harmonizuar legjislacionin e Kosovës me dispozitatë përkatëse të BE-së, duke përfshirë Direktivën e shërbimeve audio-vizuale por, "siç thekson raporti i Këshillit të Evropës, nevojitet më shumë punë në draft për të siguruar që ai mos t'ia nënvlerësojë pavarësinë e KPM-së dhe as të mos krijojë mospërputhje ligjore".

# Gërxhaliu: PAGESA E DËNIMIT NDAJ 'CONTOURGLOBAL', DËSHMI E FITORES SË MAFISË BALLKANIKE PËR ENERGJI ELEKTRIKE E LIDHUR ME POLITIKANË VENDORË

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 11 KORRIK - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ta miratuar pagesën prej 21 milionë eurosh si dëmshpërbim ndaj kompanisë "ContourGlobal". Kryeministri Albin Kurti në mbledhjen e qeverisë të mbajtur një ditë më parë tha se ndarja e këtyre mjeteve vjen pasi që "ContourGlobal" ka fituar ndaj Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit. "Vitet e fundit kemi shënuar fitore të njëpasnjëshme në këtë gjykatë që në vlerë të përgjithshme janë përafërsisht 7-fish më shumë se dëmshpërbimi prej 21 milionë eurosh që jemi detyruar të paguajmë në këtë rast. Duke pasur parasysh kontratën e nënshkruar nga pararendësit tanë dhe dëmet e shtetit nga ai projekt, kjo është e keqja më e vogël", ka thënë Kurti. Në lidhje me këtë çështje ka reaguar ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se pagesa e dënimit ndaj "ContourGlobal" është dëshmi e fitores së mafisë ballkanike për energji elektrike e lidhur me politikanë vendorë. "Pagesa e dënimit ndaj



'ContourGlobal' është dëshmi e fitores së mafisë ballkanike e lidhur me strukturat politike kosovare në të kaluarën. Jemi dëshmitar të asaj që Kosova është shndërruar në një shtet eksperimental ku më tepër mbrohen interesat e grupeve të caktuara dhe lufta për pushtet se sa që mbrohet interesi i shtetit, e të punohet në krijimin të mirave të cilat do të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik, stabilitetit social, të përsheptimit të proceseve integruese dhe të përmirësimit të ambientit biznesor në Kosovë. Me kujtohet

ceremonia e hapjes së pakos tenderuese dhe nënshkrimi i marrëveshjes me 'ContourGlobal' e cila u bë në objektin e Qeverisë së Kosovës para disa vitesh, dhe në pyetjen e një gazetari: Se si e vlerësoi këtë marrëveshje? Më kujtohet kur kam thënë se është një marrëveshje e rëndësishme strategjike, politike, ekonomike, integruese, sociale, por mbi të gjitha duhet të kuptohet se do të jetë vështirë të realizohet falë fuqisë lobuese të mafisë ballkanike. Dhe në këtë drejtim nuk shkoi një kohë e gjatë dhe u

arrit një vendim që të ndërpritet kontrata me 'ContourGlobal' dhe Kosova në vend që të jetë një shtet që prodhon energji elektrike për nevojat e qytetarëve dhe të biznesit, të jetë eksportuesi i energjisë elektrike, u shndërrua edhe më tutje shtet i varur nga importi i energjisë elektrike", ka thënë Gërxhaliu. Ai ka theksuar se kjo ndodhi në kohën kur Kosova dhe Evropa kishte nevojë për energji elektrike. "Ndodhi kur në Mal të Zi, Bosnjë-Hercegovinë, Serbi dhe Maqedoni të Veriut funksiononin dhe u ndërtonin

kapacitete të reja të prodhimit të energjisë elektrike në thëngjill, dhe falë patriotëve ambientale të lidhur me politikanë të kriminalizuar të vendosur në pushtetin e Kosovës, të lidhur me mafinë ballkanike - duke filluar nga Londra, Banjalluka, Beogradi, Tirana dhe Prishtina u ndërpre një projekt i cili ka pasur rëndësi strategjike për të ardhmen e Kosovës", është shprehur ai.

Gërxhaliu ka thënë se në këtë drejtim, përveç që sot je i varur nga importi, përveç që i ke dy termoelektrana që në realitet janë të vdekura por funksionojnë, sot Kosova është e gjobitur dhe e penalizuar. "Janë paguar 21 milionë euro dëme përball 'ContourGlobal'. Kjo është kur mungon përgjegjësia institucionale, kur hajdutët ndërrojnë emrin dhe nga hajdutë e kriminelë shndërrohen në biznesmenë kontroversë dhe këta biznesmenë kontroversë bëhen pjesë e politikës. Aty ku krimi e politika bëhen bashkë, atëherë nuk duhet të na habitë fakti se Kosova paguan në penale, qoftë në Telekom, Postë dhe në institucione të tjera publike, sepse kjo është vula, adresa e krimit që e ka kapluar Kosovën dhe që heshtet çdo ditë e më tepër", ka thënë Gërxhaliu.

## Rizvanolli: Gjatë muajit tetor lansojmë projektet e reja konkurruese për ndërtimin e kapaciteteve të energjisë së erës

PRISHTINË, 11 KORRIK - Ministri e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se Qeveria e Kosovës, me përkrahje të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) si këshilltar kryesor i transaksionit, si dhe me përkrahje të USAID-it, të cilët kanë qenë përkrahës edhe gjatë ankandit të parë solar, planifikojnë që gjatë muajit tetor të lansojnë projektet e reja konkurruese për ndërtimin e kapaciteteve të energjisë së erës prej 150 MW. "Në mbledhjen e qeverisë siç e patë kemi marrë vendim për autorizimin e fillimit të procedurave të tenderimit për këto kapacitete gjeneruese, si dhe për të dhënë mbështetje për këto. Dokumentacioni i tenderit si dhe skema do të përgatiten për gjatë muajve në vijim do t'i propozohen dhe do të trajtohen në kuadër të Komitetit për Partneritet Publiko-privat dhe



përmes këtyre synojmë të avancojmë edhe më tej qëllimet tona për të krijuar një sektor të energjisë më të sigurt, më të qëndrueshëm dhe më të pastër. Gjatë dizajnit dhe realizimit të

projektit do të ndjekin procedura të larta të transparencës dhe drejtësisë, të cilat kanë qenë në nivelin më të lartë përgjatë ankandit të parë solar, gjë që ka rezultuar me një ankand tejet të

suksesshëm dhe proces tejet transparent. Ndërtimi i kapaciteteve prej 150 MW të erës do të jetë i ndarë në dy procese të konkurrueshme dhe do të ofrojë marrëveshje për blerjen e

energjisë për së paku 15 vjet. Në këtë mënyrë synojmë të sigurojmë konkurrencë sa më të gjerë, në të njëjtën kohë të mundësojmë shfrytëzimin e të dhënave ekzistuese të besueshme, sa iu përket matjeve të erës, për ta optimizuar edhe përzgjedhjen e lokacioneve dhe realizueshmërinë e projekteve", ka theksuar Rizvanolli.

Ajo ka shtuar se projektet do ta përfshijnë edhe komponentin e partneritetit publik-privat (PPP) që do të realizohet për herë të parë në një projekt të tillë në rajon e përmes të cilit synojnë t'i inkurajojnë investimet e sektorit privat dhe ta dëshmojnë angazhimin e qeverisë ndaj këtyre projekteve, ta lehtësojnë mbështetjen financiare dhe ta ulin riskun e projektit, gjë që përfundimisht sjell te çmimet sa më të lira për konsumatorët.

## Aliu thotë se borxhet për shpronësime janë ulur në 24 milionë euro

PRISHTINË, 11 KORRIK - Liburn Aliu, ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka thënë se "borxhet e trashëguara"

ndër vite për shpronësimet e pronave janë ulur nga 184 milionë në 24 milionë euro. "Borxhet që i kemi trashëguar

shpronësime që kanë qenë në total 184 milionë euro dhe nga të cilat 102.8 milionë kanë qenë për pronarë të pronave private,

sot kemi arritur t'i zvogëlojmë në vlerën e tyre në 24.366 milionë euro", ka thënë Aliu në konferencë për medie.





# Nga Kamala Harris, te Michelle Obama, kush do të mund ta zëvendësojnë si kandidat kryesor në garën për president!

Pak muaj para zgjedhjeve në SHBA, Joe Biden është nën presion që t'i hapë rrugën për të kandiduar kundër Trumpit një kandidati më të ri dhe më energjik.

## Kush mund të futej në garën elektorale nëse Bideni del prej saj?

Debati i parë presidencial midis Donald Trumpit dhe Joe Biden ishte shkatërrues për presidentin aktual amerikan.

Bideni, tani në moshën 81 vjeçare, u shfaq shpesh i humbur dhe konfuz, duke lënë frekuentisht fjalinë përgjysmë dhe duke i ngecur fjalët, duke bërë që Trumpi 78 vjeçar, i njohur për fjalimet e tij emocionale, me ekstravaganca që mezi kuptohen, të dukej më i përmbledhur dhe inteligjent, në krahasim me të.

Ndërkohë që shqetësimet për moshën e Bidenit dhe aftësitë mendore të tij nuk janë gjë e re, diskutimet për këtë gjë shihen si moment kthese. Në një sondazh zhvilluar me kërkesë të sipërmarrjes mediatiqe amerikane CBS, mbas debatit presidencial, 72 përqind e gjithë votuesve të regjistruar thanë se Bideni nuk ka "shëndetin mental dhe kognitiv" për të shërbyer si presidenti i SHBA. Më shumë se gjysma e votuesve të regjistruar thanë të njëjtën gjë për Trumpin.

Mbase më shqetësuese është që 46 përqind e gjithë votuesve demokratë të regjistruar për sondazhin mendojnë se Biden nuk duhet të kandidojë për të qëndruar në post edhe një periudhë tjetër legjislativ. Ky rezultat tregon një rritje prej 10 përqind që nga muaji shkurt.

Partia Demokratike e ka kuptuar tashmë këtë. Megjithatë udhëheqësit kryesorë të saj janë në krah të Bidenit, dhe Shtëpia e Bardhë është duke thënë me ngulm se ai nuk është „absolutisht” duke dalë nga gara, spekulimet janë duke u shtuar për kandidatët e mundshëm që mund të futen në garë për tu përballur me Trumpin në muajin nëntor. Kush pra mund të futet kaq vonë në lojë për të vazhduar fushatën e Bidenit?

Personi i dytë në hierarki pas Bidenit, Kamala Harris, është zgjedhja më e mundshme për kandidatit tjetër demokrat. Në vitin 2020 ajo hyri në histori duke qenë gruaja e parë, personi i parë me ngjyrë dhe personi i parë me origjinë indiane që merr postin e zëvendëspresidentit amerikan.

Por gjatë qëndrimit të saj në Shtëpinë e Bardhë, Harris e ka patur të vështirë të zerë vend si udhëheqëse politike e pavarur nga Bideni. Në ditët e hershme të administratës së Bidenit, ajo u ngarkua me drejtimin e përgjigjes që Amerika i jep migracionit masiv që vjen nga Amerika Latine.

Ajo dështoi krejtësisht në uljen e migracionit dhe fushata zgjedhore e Trumpit është duke e përdorur këtë gjë kundër saj.

Që nga viti 2023 Harris ka qenë duke krijuar profilin e saj si zë për të drejtat e riprodhimit, madje duke u kthyer në zëvendëspresidentin e parë në histori që viziton një klinikë aborti, vizitë që e zhvilloi marsin e këtij viti. Identiteti i saj gjinor dhe trashëgimia mund ta ndihmojë të sigurojë më shumë mbështetje nga votuesit femra, me ngjyrë, dhe nga Azia Juglindore. Në të njëjtën kohë, karriera e saj si prokurore në Kaliforni e bën atë të jetë e hapur ndaj sulmeve që vijnë nga një pjesë e të majtës, akuza që mund të përmbledhen më mirë në sloganin “Kamala është një police”, akuza që e ndoqën gjatë kandidimit të saj në garën presidenciale të vitit 2019.

Në sondazhin e zhvilluar nga Ipsos këtë javë, Harris mori për një garë të mundshme vetëm një përqind më pak se Trumpi (Harris' 42% në krahasim me Trumpin 43%). Sidoqoftë, i njëjti sondazh e nxorri Trumpin dhe Bidenin me pikë të barabarta, ku secili prej tyre mendohet të marrë 40 përqind të votave. Harris është 59 vjeç.

Governatoja e Michiganit, Gretchen Whitmer është 52 vjeç dhe me pushtet legjislativ në Partinë Demokratike. Ajo ka vënë në jetë disa politika progresive në shtetin e saj, përfshirë kredi më të mëdha taksore për familjet me të ardhura të pakta, mbrojtje më të madhe për grupet LGBTQ+, disa masa për kontrollimin e armëve, dhe sigurimin e fondeve për t'i bërë më ekologjike firmat e automobilëve me bazë në Detroit. Në vitin 2020, ajo u përball me një komplot të një grupi të krahut të djathtë, të cilët e rrëmbyen dhe e nxorën para "gjiqit" për gjoja tejkallim kompetencash, në lidhje me masat e marra për vendosjen e shtetrrëthimit gjatë COVID-19 në Miçigan.

Vetëm nëntë ditë pas arrestimit të komplotistëve, Trump mbajti një miting në Miçigan ku tregoi edhe një here qëndrimin e tij kritik ndaj politikës që Whitmerit ka përdorur gjatë pandemisë, duke u thënë mbështetësve të tij "futeni brenda". Whitmer ka ende popullaritet në Miçigan, një shtet ku të dy partitë kryesore kanë mbështetje gati të njëjtë, dhe pritet të kandidojë për presidente në vitin 2028. Duke ndjekur debatin aktual Trump-Biden, sipërmarrja mediatiqe, Politico citoi një burim që nuk e thotë emrin, sipas të cilit Whitmer është ankuar duke thënë se Bideni nuk do të jetë në gjendje të fitojë në Miçigan.

Whitmer e hodhi poshtë këtë pretendim si të gabuar. "Unë jam krenare të mbështes Joe Bidenin në kandidimin e tij dhe jam 100 përqind krah të tij në luftën për të mposhtur Donald Trumpin," tha



ajo në një deklaratë.

Governatori i Kalifornisë Gavin Newsom e mbrojti me shpejtësi Bidenin në debatet që pasuar dhe nuk u mor me thirrjet për të hequr dorë. "Ju nuk i ktheni kurrizin (kandidatit tuaj) për shkak të një aktiviteti. Çfarë lloj partie e bën këtë gjë?" i tha Newsom kanalit televiziv amerikan, MSNBC.

Sidoqë të jetë, Newsom përmendet shpesh si pasardhës i mundshëm nëse Bideni heq dorë. 56-vjeçari ka punuar në biznes dhe ka shërbyer si Kryetar Bashkie i San Franciskos, para se të zgjidhej dhe rizgjidhej guvernator i Kalifornisë, shtetit më të populluar dhe më të pasur të Amerikës.

Por lidhjet e biznesit të Newsomit dhe karriera politike mund të përdoren kundër tij nga fushata e Trumpit, sidomos për çështjen e rritjes së numrit të të pastrehëve në shtetin e tij dhe shtimin e vjedhjeve nëpër dyqane në San Francisko.

Governatori i Illinoisit, Jay Robert "JB" Pritzker ka lindur në një nga familjet më të pasura të botës. 59-vjeçari është trashëgimtar i pasurisë së Hoteleve Hyatt dhe ka një rrjet me vlerë prej rreth 3,5 miliardë dollarësh (2.78 miliardë euro), siç vlerëson revista e bizneseve, Forbes.

Pritzker ka kohë që e përdor pasurinë e tij për të mbështetur Partinë Demokratike dhe fushatën e tij të kandidimit. Në vitin 2008, ai i diskutoi ambicjet politike në një bisedë telefonike me ish-guvernatorin e atëhershëm, tashmë të larguar të Illinoisit, Rod Blagojevichin. Pritzker nuk pranon të ketë bërë ndonjë gabim në këtë çështje.

Miliarderi u bë guvernator i Illinoisit në vitin 2018. Që nga ajo kohë ai ka punuar me politika progresive në kontrollimin e armëve, të drejtat e LGBTQ+, të drejtat e riprodhimit, imigracionin, dhe rrogën minimale.

Duke ndezur më shumë garën presidenciale midis Trumpit dhe Bidenit, Pritzker kritikoi ashpër

kandidatin republikan, duke e goditur atë si "fajtor të dënuar, përdhunues që ka përfunduar në gjyq dhe si gënjeshtar të lindur."

Pritzker e ka quajtur Trumpin po ashtu „racist, seksist, narcist mizogjen që kërkon të përdorë pushtetin për të pasuruar veten dhe për të goditur këdo që guxon të thotë një fjalë kundër tij."

Trump u përgjegj me sjelljen e tij tipike fëmijërore duke e quajtur Pritzkerin "të lerosur" dhe "buf," dhe tha se guvernatori i Illinoisit ka qenë "emocional" në drejtimin e biznesit familjar.

Ministri aktual i transportit, Pete Buttigieg ka qenë një figurë politike që nuk binte në sy para se të kandidonte për president në vitin 2022 dhe të siguronte më pas një vend në administratën e Bidenit. Por karriera e tij politike ka qenë më mbresëlënëse se kaq: Mbas përfundimit të studimeve në Harvard, Buttigieg vazhdoi studimet në Oksford, dhe punoi në kompaninë e këshillimeve, McKinsey. Karriera e tij tetëvjeçare me marinën e SHBA, përfshijnë gjashtë muaj në Afghanistan, si oficer inteligjence.

Ai u bë kryetar Bashkie në South Bend, një qytet i vogël në shtetin e Indianas, në vitin 2011 dhe u fut në kandidimin për president në 2019, për t'u larguar nga gara në favor të Bidenit. Ai ka qenë një nga kandidatët e parë gay që futet në garën për tu zgjedhur president.

Me moshën 42-vjeçare, ai është me diferencë të madhe kandidati më i ri i listës.

Governatori i Pensilvanisë, Josh Shapiro ka mbështetje të gjerë në shtetin e tij, i cili do luajë një rol të rëndësishëm në betejën kundër Trumpit, në nëntor. Shapiro ka treguar se është udhëheqës bipartizan, në favor të shkurtimeve të taksave për korporatat, por edhe të rekrutimit të më shumë oficerëve të policisë. Gjatë pikut të pandemisë së COVID-19, Shapiro shtroi në pyetje disa nga masat e marra për maskat dhe vaksinat. Këto

qëndrime mund të largojnë votuesit nga komunitetet më liberale.

Një pikë tjetër diskutimi mund të jetë mbështetja e madhe e Shapiros për Izraelin. Një pjesë në rritje e elektoratit ka qenë kritike ndaj mosdhënies së mbështetjes së Bidenit për fushatën ushtarake në Gaza, në të cilën janë vrarë mbi 38 mijë civilë duke e kthyer enklavën në prag të urisë. Kritikët i bëjnë thirrje presidentit amerikan të japë mbështetje financiare dhe ushtarake për Izraelin, në mënyrë që të ndalohen vrasjet.

Shapiro, ndërkohë ka akuzuar kolegët amerikanë se nuk kanë luftuar antisemitizmin në protestat pro-palestineze të zhvilluara në SHBA. Në maj ai tha se "ka kaluar koha" kur Universiteti i Pensilvanisë „shpërndau kampin” e studentëve protestues. Më parë, duke pasuar një valë të ngjashme protestash studentore në kampuset e SHBA, studentët e Universitetit të Filadelfias uzurpuan sipërfaqen e kolegjit për të protestuar kundër luftës që Izraeli bën në Gaza.

Duke ndjekur debatin Trump-Biden, Shapiro pranoi se Bideni "kaloi një natë të keqe" duke vënë në dukje se Donald Trump ka qenë "president i keq".

Ish-zonja e parë Michelle Obama është kandidatja e vetme në këtë listë që nuk ka mbajtur ndonjëherë ndonjë post politik dhe e vetmja që sondazhet e vendosin shumë para Trumpit, nëse ajo vendos të futet në garën elektorale.

Këtë javë sondazhet e Ipsosit e nxorën atë fituese të 50 përqind të votave, kundrejt Trumpit me vetëm 39 përqind.

Michelle Obama ka përsëritur disa herë se nuk është e interesuar të kandidojë për presidente. Por nëse politika e SHBA na ka treguar diçka javët e fundit, ajo ka qenë se asnjë rezultat elektorat nuk është aq i pamundur të arrihet, sa që dikush të vendosë të heqë dorë prej tij paraprakisht./DW

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Kosova bëhet me Ligj të ri për Sportin

**PRISHTINË, 11 KORRIK** - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar pro Ligjit të ri për Sportin. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka njoftuar se për "reformën më të thellë sportive" është punuar dy

vjet profesionalisht dhe në bashkëpunim me të gjitha strukturat në vend. Ligji i ri për Sportin parasheh: Riorganizim të sistemit institucional në sport; Fuqizim dhe funksionim efikas të organizatave

qendrore sportive; Përcaktim i kushteve dhe kriterëve për sportistin, trajnerin, agjentin sportiv dhe të gjithë aktorët e tjerë; Financim të qëndrueshëm dhe transparent të të gjitha organizatave sportive;

Planifikim, investim, menaxhim dhe mirëmbajtje efektive të infrastrukturës sportive. "Me këtë ligj vendoset standard i ri i zhvillimit të politikës sportive në vend", ka njoftuar MKRS-ja.



## Kosova e gatshme për kampionatin e grupmoshës U20

### "Epoka e re"

**PRISHTINË, 11 KORRIK** - Në prag të Kampionatit Evropian për hendbollistë të grupmoshës U20, që prej 13 deri më 21 korrik mbahet në Prishtinë, të enjten është mbajtur një konferencë për medie. Konferenca është mbajtur në hapësirat e Pallatit të Rinisë në Prishtinë, ku edhe zhvillohet Evropiani për hendbollistët deri në 20-vjet.

Presidenti i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, ka folur për përgatitjet e bëra, rëndësinë e organizimit të Evropianit në Kosovë dhe përfitimet e shumta nga kjo ngjarje. Ndërkohë selektori Bujar Qerimi ka folur për përgatitjen e Kombëtares U20 të Kosovës dhe për synimet.

Presidenti i FHK-së, Eugen Saraçini, ka thënë se janë bërë të gjitha përgatitjet që kampionati të zhvillohet në mënyrën më të mirë. "Jemi në prag të fillimit të Kampionatit Evropian U20 për hendbollistë. Mund të them që ne

si Federatë kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e mbarë të këtij kampionati. Do të jemi nikoqirë të ekipeve kombëtare të 12 shteteve. Do të jenë mbi 300 përfaqësues, duke përfshirë edhe gjyqtarët dhe zyrtarët e ndeshjeve. Kemi bërë të gjitha përgatitjet, duke filluar nga vendosja, transporti dhe që të gjitha elementet e nevojshme për organizimin e këtij kampionati të jenë në rregull. Dhe çdo gjë të shkoj sipas protokolleve të përcaktuara", ka thënë Saraçini.

"Në këtë organizim të madh do të jenë të përfshirë, përveç bashkëpunëtorëve të FHK-së, edhe dhjetëra vullnetarë që do të marrin pjesë në këtë organizim, por edhe anëtarë të klubeve të ndryshme të hendbollit që në mënyrë vullnetare do të jenë të përfshira në organizimin e këtij eventi të rëndësishëm. Për bashkëpunimin dhe përkrahjen që kemi pasur në aspektin organizativ dhe financiar, duhet theksuar MKRS-në, partnerin kryesor të FHK-së në këtë event dhe jo vetëm, pastaj Ministrinë e Punëve të Jashtme,



Punëve të Brendshme, përkatësisht policinë. Disa partnerë të tjerë si IPKO, RTV 21, NLB, KEP, Spitali Kavaja, por gjithashtu kryeqyteti ynë ka shpallur ditën e sportit dhe në këtë event jemi partnerë të rëndësishëm me komunën e Prishtinës që na ka ofruar ndihmë të parrezervë për këtë organizim", ka deklaruar Saraçini, i cili ka ftuar të gjitha mediat të jenë pjesë e këtij eventi. "Ne kemi filluar përgatitjet edhe për Evropianin U18 që do të mbahet muajin e ardhshëm. Është

e rëndësishme që mbi 300 pjesëmarrës janë në Evropianin U20. Edhe në aspektin financiar do të ketë shpenzime që do t'i bëjnë pjesëmarrësit, kështu që benefiti i ekonomisë së qytetit do të jetë i shumëfishtë. Kjo nënkupton që ne me infrastrukturën ekzistuese duhet të jemi në gjendje ta zhvillojmë atë edhe më shumë, që të jemi të gatshëm të organizojmë edhe Kampionate Evropiane, por edhe Botërore. Shpresojmë që edhe Kombëtarja jonë U20 të shënojë

rezultate të mira", ka deklaruar Saraçini.

Ndërsa përzgjedhësi Bujar Qerimi ka deklaruar se janë përgatitur për të zhvilluar një kampionat të mirë dhe synohet që të arrihet një nga katër pozitat e para. "Përgatitjet për këtë garë të rëndësishme për ne i kemi ndarë në tri faza. Faza e parë ishte për përgatitjen fizike dhe është bërë në Pejë. Ishte punë dhjetëditore. Pjesa e dytë prapë në Pejë, por fokusi ishte në përgatitjen taktike dhe teknike të Kombëtares. Është dashur të bëhet komponimi dhe automatizimi i lojës. Pjesa e fundit është kryesore. Jemi në prag të fillimit të garës në Evropianin B. Dje patëm miqësore me Britaninë e Madhe. Kemi parë disa probleme të vogla. Do të mundohemi t'i përmirësojmë që të jemi sa më mirë në aspektin tekniko-taktik. Fokusi kryesor është që këta lojtarë ta gjejnë veten sa më mirë që rezultati të jetë në plan të parë. Besojmë dhe kemi punuar sa ishte e mundur. Jemi përgatitur mirë që të mbërrijmë në katër ekipet e para", ka deklaruar Qerimi.

## Zyba pas transferimit në Slovan Liberec: Do të jap maksimumin



**LIBEREC, 11 KORRIK** - Qëndrim Zyba ka kompletuar transferimin te skuadra çeke Slovan Liberec. Mesfushori kosovar u largua nga Ballkani, ku karrierën do ta vazhdojë në elitën e futbollit çek te skuadra bardhekaltër. Zyba ka folur për faqen zyrtare të klubit pas zyrtarizimit si lojtari i ri i Slovan Liberec, duke thënë se pret të jap maksimumin për arritjen e objektivave të klubit. "Shpresoj që në tri vitet e ardhshme gjithçka të shkojë

sipas planit në Liberec dhe të vazhdojë të përparoj në futboll dhe të jem i suksesshëm. Më pëlqen të luaj me topin në qendër të fushës dhe sigurisht që mund të mbështes edhe sulmin. Këtë do të përpiqem ta bëj edhe në Slovan", ka thënë Zyba. Një nga mesfushorët më të mirë të futbollit të Kosovës ndër vite ka thënë se pritja në Liberec ka qenë mjaft e mirë. "Skuadra është shumë miqësore dhe jam i lumtur për këtë sepse do të jetë

familja ime", buzëqesh mesfushori.

Në të njëjtën kohë ai tregon ambiciet e tij për vitin e ardhshëm: "Do të përpiqem të bëjmë gjithçka për të qenë sa më lart në tabelë. Do të kemi nevojë për ndihmën e tifozëve, sepse kur jemi bashkë jemi më të fortë".

Zyba tashmë i ishte bashkuar skuadrës në përfundim të kampit stërvitor në Austri para fillimit të sezonit.

## Lista e Kosovës U20 për Kampionatin Evropian

**PRISHTINË, 11 KORRIK** - Përfaqësuesja e Kosovës U20 në basketboll do të marrë pjesë në Kampionatin Evropian për këtë grupmoshë.

Tanimë trajneri Dritëro Sefaja ka publikuar edhe listën me 12 basketbollistët e ftuar për këtë ngjarje të madhe. Ky Evropian do të mbahet nga 12

deri më 21 korrik në Rumani. 12 lojtarët që do ta përfaqësojnë Kosovën në FIBA U-20 Kampionatin Evropian: Anesh Gashi, Bardh

Istrefi, Eliot Peci, Eris Zeneli, Genc Zeqiri, Jon Ismajli, Jon Ukaj, Norik Binçe, Olsi Kurtaj, Orges Shatri, Rron Dahsyla, Ardian Ibishi.



## Yamal: Evropianin e fundit e kam parë në një qendër tregtare, tani jam në finalen e tij

BERLIN, 11 KORRIK - Sulmuesi Lamine Yamal shijon momentin e tij të lavdisë ndërkombëtare. Pas pak ditësh ai do të mbushë 17 vjeç, por mosha e tij shumë e re nuk e pengoi të shkojë në finalen e "Euro 2024" si protagonist në radhët e Spanjës. Ai realizoi golin e tij të parë në një

Evropian, një gol të jashtëzakonshëm nga jashtë zone ndaj Francës, duke udhëhequr ekipin e tij në një moment të vështirë. Një lojtar që po tregon personalitet edhe pse ende adoleshent. Yamal kujton një episod mjaft interesant të jetës së tij, kur kujton se ku ishte duke parë

një event të tillë tri vjet më parë: "Në minutën e 60 fillova të mendoja se do të shkonim në finale, por nuk e shprehja derisa ra bilibili. U gëzova shumë, sepse mbaja mend si dhe ku kam përjetuar kampionatin e fundit evropian të futbollit. Asokohe kam qenë në një qendër tregtare me

shokët e mi për ta parë ndeshjen. Sot jam shumë i lumtur, pasi jam në finalen e këtij turneu", ka thënë Yamal. "Për mua është një ëndërr që bëhet realitet, të jem në finalen e një Evropiani. Ndaj Francës nuk e di nëse ishte goli më i mirë i të gjithë kompeticionit, por për mua ishte më i veçantë,



sepse ishte goli im i parë me kombëtaren", ka shtuar Yamal.

## Southgate: Kemi ndryshuar shumë për të arritur deri këtu, ta çojmë deri në fund atë që nisëm

BERLIN, 11 KORRIK - Anglia rikthehet në finalen e një Evropiani në futboll pas atij që humbi në shtëpinë e tij tri vjet më parë me penallti ndaj Italisë. Këtë herë, kombëtarja e "3 luanëve" do të përballet me Spanjën në Berlin. Ashtu si asokohe, në krye të kombëtares është ende Gareth Southgate. Trajneri i Anglisë foli sot për "ITV Sport" pas fitores kundër Holandës në gjysmëfinale. Një fitore që erdhi në minutën e fundit të kohës së rregullt. "Kemi luajtur dhe djersitur shumë. Ishte një lojë e ndërlikuar dhe ne duhej të vazhdonim ta ndryshonim mënyrën se si u rreshtuam në mbrojtje. Mbi të gjitha na duhej të përshtateshim vazhdimisht dhe lojtarët morën shumë vendime të mira", ka thënë Southgate. "Përfundimi i ndeshjes, ai gol, fitorja dhe dalja sërish në finale është i veçantë



për ekipin dhe është një shpërblim për atë që po i japin kauzës. Tani të punojmë për ta çuar deri në fund këtë që nisëm", ka deklaruar trajneri anglez. "Gjëja më e rëndësishme është që i gjithë ekipi të jetë gati për të hyrë në lojë. Ne ndjemë, nga pikëpamja energjike, se kishim filluar të humbim pak aftësinë kur shtypnim dhe Kane u

dëmtua", u shpreh Gareth Southgate, që aktivizoi Watkins, njeriun që realizoi golin e fitores. "Watkins bëri mirë dhe ushtroi presing te rivalët. Ne menduam se ishte një kohë e mirë për ta provuar që ai të luante dje, ndaj jam shumë i lumtur që Ollie mori momentin e tij, duke shënuar dhe na dha fitoren", ka përfunduar Southgate.

## Wolff paralajmëron rivalët: Nuk ndalemi me dy fitore

SHTUTTGART, 11 KORRIK - Mercedesi ka fituar dy garat e fundit të Formulës 1, duke u rikthyer pretendente. Sigurisht që fati i "dha një dorë" në Austri, por makina gjermane ka qenë gjithmonë në vendet e para në garat e fundit, ka mundur të përfitojë nga gabimet e të tjerëve, duke treguar një rritje shumë domethënëse. Një rritje që nuk duan ta ndalin te skuadra nga Brackley, ndaj po mendojnë për risitë e radhës, të cilat do të prezantohen që në garën tjetër në Hungaroring. Si në Hungari ashtu edhe në Belgjikë (pista e SPA), Mercedes do të sjellë risi të tjera në W15-en e tij, siç konfirmohet nga drejtori i ekipit Toto Wolff. "Jam i kënaqur me ekuilibrin që kemi arritur. Si ta balancojmë makinën dhe si t'i shfrytëzojmë në maksimum risitë ishte aspekti kryesor. Po gjejmë performancën



dhe kjo përkthehet në kohë të shpejtë për xhiro, gjë që nuk ka ndodhur në dy vitet e fundit", ka thënë menaxheri austriak i Mercedesit. "Do të ketë ndryshime të tjera për sa i përket performancës. Do të sjellim përditësime të tjera si në Hungari ashtu dhe në SPA, por ne nuk

duhet të rrëmbehemi nga fitoret. Në Austri fituam pasi patëm edhe ritmin e duhur. Kjo na bëri të kuptonim se situata do të përmirësohej, por nuk e mendonim se ky rezultat do të vinte në Silverstone, sepse nuk kishim pothuajse asgjë të re në makinë", ka thënë Wolff.

### SHKURT

#### Belingham: Të dielën do të shkojmë dhëmbë për dhëmbë me Spanjën

Sulmuesi i Anglisë, Jude Bellingham, duke folur për "BBC Radio 5 Live", shprehu besimin që "Tre Luanët" do t'i kenë shanset e tyre për një triumf të mundshëm në finalen ndaj Spanjës. "Jam vërtet krenar për djemtë. Reagimi, qëndrimi dhe mentaliteti. Cilësia është një gjë, por ato karakteristika nuk mund t'i mësoni në stërvitje. I merrni nga përvoja dhe njëri-tjetri. Tani kemi një ndeshje më shumë. Ne jemi të lodhur, ka qenë një sezon i gjatë, por kjo është një shtytje e fundit për vendin tonë dhe për historinë", ka thënë ylli i Realit të Madridit, i cili luan shumë edhe për "Topin e Artë" në rast të një suksesi në Berlin të dielën. "Goli i Watkins? I jemi me të vërtetë mirënjohës, sepse nuk jam i sigurt nëse kisha një tjetër 30-minutësh në këmbët e mia. Ai është heroi dhe na shpëtoi. Spanja është dukur e mrekullueshme, ata janë dukur shumë mirë në këtë Evropian. Tani ne do të ulemi dhe do të analizojmë se si ata luajnë për të kuptuar më mirë se çfarë duhet të bëjmë të dielën. Do ta bëjmë analizën e duhur për këtë ndeshje. Është vetëm një ndeshje teke dhe gjithçka mund të ndodhë. Do të jetë interesante të shkojmë dhëmbë për dhëmbë me ta", ka deklaruar Bellingham.

#### Koeman: Nuk patëm fat, por kemi zhvilluar një Evropian të mirë

Anglia ia doli të triumfojë në gjysmëfinalen e dytë të "Euro 2024", përballë Holandës 2-1, duke siguruar biletën e finales së madhe, ku do ta kërkojë trofeun tri vjet pasi dështoi të bëjë diçka të tillë në finalen e "Webleyt" ndaj Italisë. Të dielën e 14 korrikut në finale ata gjejnë Spanjën, skuadrën që ka bindur më së shumti në këtë evropian, por në finale janë 90 minuta ku gjithçka mund të ndodhë ndaj Anglia do t'i tentojë shanset e veta. I zhgënjyer Ronald Koeman, me teknikun holandez i cili e komentoi kështu humbjen ndaj Anglisë: "Anglia na vuri në vështirësi sidomos gjatë pjesës së parë, sidomos në repartin e mesit të fushës vuajtëm shumë, nuk kontrolluam si duhet Foden dhe Bellingham". "Ndjesia ime ishte që në 20-25 minutat e fundit ishim më të freskët fizikisht, por u ndëshkuam nga një gol në fund. Ky është futbollit. Nuk më ngelet gjë tjetër vetëm t'ju them se jam krenar për këta djem dhe për gjithë rrugëtimin e skuadrës tonë në këtë evropian", ka shtuar Koeman.

#### PSG-ja ofron 200 milionë euro për dyshen Osimhen - Kvaratskhelia, Napoli e refuzon

PSG-ja nuk heq dorë nga Victor Osimhen dhe Kvaratskhelia. Kampionët e Francës duan t'u dhurojnë tifozëve dy goditje të mëdha pas largimit të Kylian Mbappes drejt Realit të Madridit. "Corriere dello Sport" raporton se drejtuesit e PSG-së kanë ofruar 200 milionë euro për kartonët e dy yjeve të Napoli. Propozim që është refuzuar menjëherë nga Napoli, që u ka bërë të ditur francezëve se në merkato ndodhet vetëm sulmuesi nigerian. Kvara cilësohet i pashitshëm nga presidenti De Laurentiis dhe trajneri Conte, ndërkohë që për Osimhen janë të hapur për bisedime. Me këto largime Napoli do ta nisë operacionin për transferimin e Romelu Lukakut, futbollistit të preferuar të trajnerit Antonio Conte.

## Corinthiansi e dëshiron Balotellin

Sulmuesi italian Mario Balotelli mund të luajë në Brazil sezonin e ardhshëm. Për 33-vjeçarin ka ardhur një ofertë nga skuadra e Corinthiansit. Balotelli është për momentin pa skuadër, pasi ka

lënë me parametrin zero skuadrën turke të Adana Demirspor, ku luajti sezonin e kaluar (7 gola në 16 ndeshje). Sipas "Uol Esporte", skuadra e njohur braziliane kërkon ta sjellë

sulmuesin italian, por bisedimet nuk duken të lehta. Balotelli kërkon 4.5 milionë euro në sezon, ndaj dhe kontaktet vijnë për të gjetur një marrëveshje. Sulmuesi nuk ka

luajtur kurrë jashtë Evropës, ndërkohë që është aktivizuar në Itali, Angli, Turqi, Francë e Zvicër. Tashmë një aventurë në Brazil mund të ishte ideale për të edhe pse ka shumë të

panjohura. Balotelli ende nuk ka vendosur se ku dëshiron të luajë, por duket se tentohet nga një aventurë e tillë, në një kampionat ku edhe mund të argëtohet jashtë fushe.



## Njoftim

Pas dorheqjës së Kryetarit, dhe kryesisë së klubit Fc Vushtrria,

ju njoftojmë për thirrjen e kuvendit të jashtëzakonshëm të klubit të futbollit FC Vushtrria.

Në këtë kuvend të jashtëzakonshëm do të zgjedhet Kryetari, kryesia, dhe strukturat drejtuese të klubit.

Kuvendi mbahet me datë: 20.07.24 në ora: 18:00 në sallën e kuvendit Komunal në Vushtrri.

Me respekt, FC Vushtrria



## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “TECH PARTNERS” Sh.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 811925554 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “TECH PARTNERS” D.O.O. od Kosova Polje, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 811925554 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “TECH PARTNERS” L.L.C. with headquarters Fushë Kosova, has come to the decision to quit its business: 811925554 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fjolla Delija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Samson Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e sh.m.t. “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1909

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
0.5L

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

